



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19 Prill 2023

Nr: 386

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 251, TË KOALICIONIT PËR
REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ KRYETARIT TË
BASHKISË LUSHNJE DHE PERSONIT PËRGJEGJËS PËR BASHKINË LUSHNJË, PËR
ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË PUBLIKE TË NDALUAR NGA KOMISIONI QENDROR I
ZGJEDHJEVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14
MAJ 2023**

Sot më datë 19 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: Zj. Eriselda Sefa, kryetar i bashkisë Lushnje
Zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lushnje

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa, kryetar i bashkisë Lushnje dhe zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës në bashkisë Lushnjë, për zhvillimin e veprimtarisë publike të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Data: 19 Prill 2023

Nr: 386

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa, kryetar i bashkisë Lushnje dhe zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 07.04.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, është informuar nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për zhvillimin e veprimtarisë publike të raportuar për t'u zhvilluar në datën 30.03.2023 me temë "Inspektim punimesh, palestra e shkollës "Foto Puka" nga bashkia Lushnje, e cila ishte kategorizuar me vendimin nr. 212, datë 28.3.2023 nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, si veprimtari "e ndaluar" për zhvillim.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 25.3.2023, bashkia Lushnje ka raportuar veprimtarinë publike me objekt "Inspektim punimesh palestra e shkollës 'Foto Puka' Lushnje", për t'u zhvilluar në datë 30.03.2023 ora 10:15. Në raportim është shënuar se folësit kryesorë do të jenë kryetari i bashkisë dhe drejtuesi politik, pjesëmarrësit: Taulant Balla, Eriselda Sefa.

Me vendimin nr. 212, datë 28.3.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur ndalimin e zhvillimit të pesë aktiviteteve të raportuara për t'u zhvilluar në datën 30 Mars 2023 nga bashkia Lushnje. Ky ndalim është pasqyruar edhe në ndërfaqen e aktiviteteve të ndaluara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është bazuar në arsyetimin se nga të dhënat e paraqitura në raportim u konstatua se aktivitetet e zhvilluara nga institucioni publik, bashkia Lushnje, me pjesëmarrjen e personave partiakë përbëjnë veprimtari të ndaluara, në përputhje me nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Në listën e aktiviteteve të ndaluara sipas vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është edhe aktiviteti: *"Inspektim punimesh, palestra e shkollës "Foto Puka" Lushnjë (ripublikim, me media sociale)", me pjesëmarrës: Taulant Balla, Eriselda Sefa, raportuar më datë 25 Mars 2023 për t'u zhvilluar më datë 30 Mars 2023"*.

Në përputhje me parashikimet e nenit 9, pika 1, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, ndalimi i veprimtarive publike nëpërmjet shkrimit "Ndaluar nga KQZ-ja", është pasqyruar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Më datë 29.3.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet adresës së postës elektronike, ka njoftuar personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, mbi veprimtaritë publike të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 07.04.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, nga KRIIK ka marrë denoncimin për zhvillimin e veprimtarisë së ndaluar nga bashkia Lushnje.

Në këtë denoncim pretendohet si vijon: *“Konstatohet se aktiviteti është zhvilluar me pjesëmarrjen e gjithë personave për të cilët ishte bërë njoftimi”.*

Nga kontrolli i bërë në faqen zyrtare të Facebook të kryetares së bashkisë Lushnje, rezulton të jenë postuar foto që faktojnë zhvillimin e aktivitetit të ndaluar.

Fotot mbi këtë aktivitet, deri në momentin e dërgimit të këtij denoncimi, rezultojnë se kanë marrë 418 pëlqime, iu janë bërë 38 komente, si dhe janë ri-shpërndarë 27 herë në faqe apo profile të tjerë të përdoruesve të Facebook (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes).

“Palestra e shkollës-“Foto Puka” falë punës që po kryhet do jetë brenda pak javësh një ambient modern dhe funksional jo vetëm për nxënësit e shkollës, por edhe për ekipet e lojërave me dorë të Lushnjes.

#ShqipëriaEArdhmjaJonë

#SkaKohëPërPushim”

Më datë 07.04.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet adresës së postës elektronike, njofton personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike zj. Erisa Qalliu, mbi denoncimin e administruar dhe kërkon informacion në lidhje me njoftim që i është bërë kryetarit të bashkisë Lushnjë, mbi ndalimin e veprimtarive publike.

Nëpërmjet e-mail të datës 07.04.2023, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lushnjë, vendos në dispozicion të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shkresën nr. 2747/1 prot., datë 29.03.2023 me lëndë “Vënie në dijeni”, nëpërmjet së cilës kryetari i bashkisë zj. Eriselda Sefa, është vënë në dijeni mbi veprimtaritë publike të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, rezultoi se bashkia Lushnje, ka zhvilluar aktivitetin e ndaluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas planifikimit të raportuar.

Pavarësisht këtij ndalimi, zj. Eriselda Sefa, kryetar i bashkisë Lushnje ka zhvilluar aktivitetin e ndaluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas planifikimit të raportuar.

Data: 19 Prill 2023

Nr: 386
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa kryetar i bashkisë Lushnjë dhe personit përgjegjës zj. Erisa Qalliu”

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Lushnje, përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Lushnje, është zj. Erisa Qalliu, me funksion Drejtor i Burimeve Njerëzore, i caktuar me autorizim nga titullari i institucionit.

U provua se personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, ka marrë dijeni për ndalimin e veprimtarisë publike nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe në kushtet që është person i ngarkuar me detyra nga Kodi Zgjedhor, zj. Erisa Qalliu, duhet të sanksionohet sipas pikës 1, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor.

U provua se zj. Eriselda Sefa, kryetari i bashkisë Lushnje, ka marrë dijeni mbi vendimmarrjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve mbi veprimtarinë publike të ndaluar.

Bazuar në përcaktimet e nenit 10, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator *“Në rast se Komisioneri konstaton se Titullari i institucionit ka penguar raportimin sipas këtij vendimi, ka ndikuar apo urdhëruar që ai të raportohet me vonesë, apo veprimtaria apo aktiviteti publik është zhvilluar pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, titullari i institucionit ndëshkohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë sipas nenit 169, të ligjit nr .10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.*

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenin 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë ndaj zj. Eriselda Sefa, kryetar i bashkisë Lushnje në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

Data: 19 Prill 2023

Nr: 386
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa kryetar i bashkisë Lushnje dhe personit përgjegjës zj. Erisa Qalliu”

2. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë ndaj zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarisë publike në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 19 Prill 2023

Nr: 386
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj zj. Eriselda Sefa kryetar i bashkisë Lushnjë dhe personit përgjegjës zj. Erisa Qalliu”